

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zjarret në vend/ 12 vatra ende aktive, flakët përfshijnë disa qarqe, qindra forca dhe 4 helikopterë në terren Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/zjarret-ne-vend-12-vatra-ende-aktive-flaket-perfshijne-disa-qarqe-qindra-forca-dhe-4-helikoptere-ne-terren/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:24:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 19:06:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7b8d035c4edda0672eff5c35706ecb7da56ce4463b7d3366e0825d522cbea7d1
TEKSTI	60f7f83e34b9de5fed9f0897e426cdb15e78bbca95342ad0642326b391854fd0
PAMJA	3afa67da3cfbc5d438415876f7b32b3cf4ed6321eee93617e33536503b6a8287

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c16e40eb2b6cef84cfa6664ef6260933d04ccb480559fd0508515b37a63c3d09
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c16e40eb2b6cef84cfa6664ef6260933d04ccb480559fd0508515b37a63c3d09>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet

Zjarret në vend/ 12 vatra ende aktive, flakët përfshijnë disa qarqe, qindra forca dhe 4 helikopterë në terren



Edi Hallaci

08 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Situata e zjarreve gjatë ditës së sotme vijon të menaxhohet me angazhim të lartë të strukturave operacionale në terren dhe mbështetje nga ajri.

Në rang vendi janë raportuar 22 vatra zjarri, prej të cilave 12 aktive, 9 nën mbikëqyrje dhe 1 e shuar. Në operacione janë angazhuar 498 forca vendore dhe lokale dhe 314 efektivë të Forcave të Armatosura, krahas mjeteve zjarrfikëse, mjeteve mbështetëse, autoambulancave, dronit dhe 4 operacioneve me helikopterë.

QARKU TIRANË: Në Malin e Dajtit zjarri vijon aktiv në sipërfaqe me pyll ahue dhe shkurre. Në operacion janë angazhuar 25 efektivë zjarrfikës, 7 forca të ADM-së, si dhe 55 efektivë të FA, 5 mjete, 1 autoambulancë dhe 1 helikopter. Nuk ka rrezik për zonat e banuara. Ndërkohë, vatra në Kryezi të Kavajës është shuar, ndërsa në Malin e Bërzhitës zjarri është izoluar dhe mbahet nën monitorim nga strukturat vendore.

QARKU DIBËR: Viojnë aktive vatrat në Vajkal të Bulqizës, Lundre–Madhesh në Mat, Qafën e Helmes në Bulqizë dhe Cerrujë–Mali i Allushit në Klos. Në Lundre–Madhesh, krahas forcave vendore, pyjore dhe vullnetare, operacioni mbështetet nga 22 efektivë të FA, 3 mjete dhe 1 autoambulancë. Në të gjitha këto vatra raportohet se nuk ka rrezik për zonat e banuara, ndërsa në Lundre–Madhesh zjarri ndodhet në lartësi dhe në distancë të konsiderueshme nga banesat.

QARKU LEZHË: Aktive mbeten vatrat në Gallatë të Kurbinit dhe në zonën Kalivaç–Zimaj–Kashnjet të Bashkisë Lezhë. Në Gallatë ndërhyrja vështirësohet nga terreni, por nuk ka rrezik për banesat. Një angazhim i konsiderueshëm vijon në Kalivaç–Zimaj–Kashnjet, ku janë 100 forca vendore dhe vullnetare, të mbështetura nga 124 efektivë të FA, 16 mjete, 2 autoambulanca dhe 1 helikopter. Edhe këtu nuk raportohen zona të banuara në rrezik.

QARKU ELBASAN: Vatra në Malin e Qukësit, Prrenjas, është nën mbikëqyrje dhe monitorohet nga MZSH. Në Gurëshpatë të Librazhdit zjarri vijon aktiv dhe në terren është angazhuar MZSH Librazhd me 1 automjet dhe 6 efektivë. Nuk ka rrezik për zonat e banuara.

QARKU SHKODËR: Situata po ndiqet në disa zona. Vatra mbi Ludric dhe Shopel në Fushë-Arrëz është nën mbikëqyrje. Në Mnelë të Vogël, Vau-Dejës, zjarri vijon aktiv dhe operacioni mbështetet nga 27 efektivë të FA, 3 automjete zjarrfikëse, 1 autobot dhe 1 helikopter, krahas strukturave vendore. Në Bardhaj–Myselim, vijon puna me forca të MZSH-së, Shërbimit Pyjor, bashkisë dhe vullnetarë, të mbështetur nga 43 efektivë të FA dhe mjete, ndërsa nuk ka rrezik për zonat e banuara. Vatra në Bërdicë është nën mbikëqyrje. Në Malin e Tërbunit, Pukë, zjarri vijon aktiv në pyll me pishë; në operacion janë forcat vendore dhe 32 efektivë të FA me 3 mjete dhe 1 autoambulancë. Edhe në Tërbun nuk ka rrezik për zonat e banuara.

QARKU VLORE: Në Bolenë të Himarës, vatra është nën mbikëqyrje nga MZSH Himarë. Në Qesarat të Finiqit zjarri, i shfaqur gjatë ditës së sotme në sipërfaqe me shkurre, vijon aktiv; në operacion është MZSH Finiq dhe është kryer edhe ndërhyrje me 1 helikopter.

QARKU FIER: Vatrën në Peshtan të Fierit dhe Çërrilë të Mallakastrës janë tashmë nën mbikëqyrje. Strukturat zjarrfikëse vijnë në monitorimin e tyre në terren për të parandaluar riaktivizimet.

QARKU DURRËS: Në Halil të Krujës, zjarri që ishte shfaqur pranë zonave të banuara është izoluar dhe shuar, ndërsa zona vijon të mbahet nën monitorim nga MZSH Krujë.

QARKU KUKËS: Vatra në Mamëz, njësi administrative Kolsh, e shfaqur sot në sipërfaqe me shkurre dhe pisha, është nën mbikëqyrje. Nuk ka rrezik për zonat e banuara.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) vijon të ndjekë në mënyrë të pandërprerë situatën në të gjithë territorin e vendit, në koordinim të ngushtë me prefekturat, bashkitë dhe të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Kapacitetet operacionale mbeten të angazhuara në terren dhe në gatishmëri për të ndërhyrë aty ku situata e kërkon, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave dhe pasurisë së qytetarëve.

LAJME TË NGJASHME



Zjarret në Shqipëri/ Katër vatra ende aktive në Dajt, Bulqizë, Mat dhe Skrapar, mbi 250 efektivë në terren

1 MIN



Zjarret në Shqipëri/ 4 vatra mbeten aktive, mbi 500 forca dhe 3 helikopere në terren

1.5 MIN



Terror në Haiti/ Bandat kriminale hapin zjarr ndaj qytetarëve, të paktën 30 të vrarë...

1.5 MIN



Situata me zjarret në vend/ 33 vatra në 24 orë, 8 mbeten aktive!

1 MIN



Vatër e madhe zjarri në disa fshatra në Bulqizë, kërkohet ndërhyrje emergjente nga ajri dhe në terren

1 MIN

MË TË LEXUARAT





Flasin ekspertët/Gërhiqja e partnerit nuk është thjesht bezdi, mund t'ju dëmtojë seriozisht shëndetin!



"Marshi për Liri" në mbështetje të ish-krerëve të UÇK, qytetarët nisin grumbullimin në Prishtinë



Para verdiktit, Kosova përcjell edhe njëherë mesazhin për ish-krerët e UÇK-së



Aksident në Selenicë, automjeti del nga rruga dhe bie nga një lartësi të madhe, humb jetën shoferi



Lady Gaga bëhet nënë për herë të parë



Bëni kujdes me këto shenja të zodiakut/Për të flitruar i keni 'ekspertë' por për lidhje serioze, harrojeni!



Ilaçi që mund të rikthejë flokët te personat me alopeci të rëndë...



Shenjat e zodiakut që luajnë "viktimitë" edhe kur kanë faj!



6-vjeçarja bëhet virale në rrjet, nis shkollën e vetme në fshatin me 40 banorë!



Daja para derbit me Partizanin: Do fitojë ekipi që do të bëjë më pak gabime, duhet të jemi gjithë kohës në ekuilibër!


EDITORI SUGJERON



Një dietologe tregon si të hani karbohidratet, proteinat, yndyrnat dhe fibrat për të kontrolluar...



Çfarë ndodh me trupin tuaj kur merrni ekstrakt çaji jeshil me kafeinë?!



Studim/Hemoglobina e ulët mund të çojë në...



Shumë njerëz e bëjnë çdo natë, por studimi i ri tregon një rrezik të fshehur!



Dëshironi të rregulloni kolesterolin?! Këto janë frutat që ju duhen...



Mendoni se po veproni mirë, por me këto ushqime po dëmtoni...



Kujdes! Këto ushqime nuk duhet t'i përzieni kurrë me vitaminën D...



Vaj ulliri me hudhër është i shëndetshëm për organizmin?! Ja se çfarë ndodh në të vërtetë...



Proteinat bimore apo proteinat shtazore?! Ja se cilat janë më të mira...





A duhet të stërviteni ndryshe
gjatë menstruacioneve?!
Përgjigjja mund t'ju befasojë...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të
zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet
informativ dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,
Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top
Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo
riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.